



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



WIKIMEDIANS
OF ALBANIAN LANGUAGE
USER GROUP

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH
SIGURIMIT TË SHTETIT**

**WIKIMEDIANS OF ALBANIAN
LANGUAGE USER GROUP
(WOALUG)**

Nr. 285 Prot. Datë 25/2/2019

Nr. _____ Prot. Datë ___/___/2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH), përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;

dhe

Wikimedians of Albanian Language User Group (WoALUG) përfaqësuar nga Anëtarja e Bordit, Znj. Greta Doci

Për të konsoliduar bashkëpunimin tonë në drejtime konkrete, *palët* bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “Marrëveshja”).

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është rregullimi i marrëdhënieve midis palëve për zbatimin e angazhimeve, të projekteve të përbashkëta me fokus promovimin dhe përkujtimin e vlerave, ngjarjeve që dëshmojnë periudhën për krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën që

ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit. AIDSSH do të ofrojë qasje të lirë në burime online dhe materialet e ndodhura fizikisht në AIDSSH.

Neni 2

Të drejtat e autorit dhe licenca me kod të hapur

Të dyja palët kuptojnë se të gjitha shpërndarjet e kontributeve në faqet e projekteve të Wikimedias, ose të çdo pune të bazuar në kontributin, që zhvillohet sipas kësaj marrëveshjeje, do të ofrohen sipas një licence Creative Commons Share-Alike, e cila lejon ripërdorimin e lirë nga të tjerët për përdorime jo komerciale dhe komerciale.

Neni 3

Citatet

Kur përdoren dhe citohen burimet e AIDSSH, duhet:

- Gjithmonë të jepet informacionin original i citimit, siç parashikohet në produktin përkatës të AIDSSH-së, përveç lidhjes së një artikulli [ose] të AIDSSH-së;
- Mos përdorni lidhjet e zhveshura në faqet e AIDSSH-së jo të lirë, në vend të citimit të plotë;
- Respektoni të drejtat e autorit të AIDSSH-së në përputhje me politikën e copyright të Ëikipedia dhe Kushtet e përdorimit të tyre;
- Pajtohuni me çdo kusht që shfaqet në faqet e veçanta të faqes/materialeve fizike së AIDSSH-së që po aksesohet.

Neni 4

Angazhimet

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, WoALUG dhe AIDSSH kanë të drejta dhe detyrime të angazhohen duke bashkëpunuar në fushat e tyre të kompetencës dhe të misionëve të tyre si më poshtë:

WoALUG:

- a) Mbështetje në ngarkimin e përmbajtjes së institucionit (gjegjësisht ngarkimi i imazheve në Wikimedia Commons, libra në Wikisource, të dhëna në Wikidata);
- b) Përfshirja e vullnetarëve në kontributin në Wikipedia dhe projekte të tjera të Wikimedias me përmbajtje të institucionit.
- c) Komunikimi i përmbajtjes së institucionit në komunitetin Wikimedia (dmth. Informimi i komunitetit mbi faqet e diskutimit të Wikiprojekteve specifike, në faqen e diskutimit të Wikipedia dhe projekteve të tjera në gjuhë të caktuara, përmes listave postuese relevante.
- d) Organizimi i një ngjarjeje Wikimedia (p.sh. trajnimi, prezantimi i Wikipedia dhe projekteve të Wikimedia, redaktimi në një edit-a-thon ...).

e) Digjitalizimi i përzgjedhjes së përmbajtjes së institucionit.

AIDSSH:

- a. grumbullimin e të dhënave, dokumenteve dhe dëshmive për njohjen e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- b. grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit;
- c. të bashkërendojnë në kryerjen e studimeve shkencore për rolin dhe funksionin e ish-Sigurimit në shtet dhe në shoqëri, si edhe për format e ndryshme të shfaqjes dhe ekzistencës së opozitës dhe kryengritjes ndaj regjimit komunist me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit;
- d. ofrimin e ndihmës për studiuesit e institucioneve respektive, që dëshirojnë të bëjnë kërkime shkencore në fushat respektive që ato mbulojnë sipas ligjit;
- e. shkëmbimin e vazhdueshëm të kopjeve të periodikëve që botohen nga dy institucionet, materialet shkencore dhe informative me qëllim promovimin e vlerave historike, në përputhje me interesat e palëve duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- f. organizimin e aktiviteteve të përbashkëta që kanë në fokus të tyre krimet e komunizmit në Shqipëri dhe përdhën që ka funksionuar ish-Sigurimit i Shtetit me qëllim njohjen dhe edukimin e publikimit me historinë e tij.
- g. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj marrëveshjeje.
- h. të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave dokumente dhe materiale arkivore që i përkasin periudhës së komunizmit me fokus veprimtarinë e sigurimit të shtetit dhe që i nevojiten secilës palë në funksion të veprimtarisë së punës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat;
- i. të bashkërendojnë punën për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të asaj periudhe;
- j. të organizojnë, hapin ose shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy institucionet mbulojnë sipas ligjit;
- k. të organizojnë konferenca, takime, punëtori për të nxitur ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që u janë përpunuar/ruajtur të dhënat nga ish-Sigurimit i Shtetit, gjatë periudhës së dikaturës komuniste, me qëllimin krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse për njohjen e dokumentacionit arkivor të kësaj periudhe.

Neni 5

Marrëdhënie jo-ekskluzive

Marrëveshja midis WoALUG dhe AIDSSH është e pavarur, jo-ekskluzive dhe jo-preferenciale. Ndërkohë WoALUG pranon se të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale në ndonjë nga artikujt, veprat ose materialet që shfaqen në produktet online të AIDSSH-së janë në

pronësi dhe kontrollohen nga AIDSSH (ose të licencuarit e palës së tretë) dhe nuk ka të drejtë, titull ose interes në të, WoALUG ose aplikues në bazë të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të të drejtave të kufizuara të aksesit të shprehura shprehimisht për këtë.

Neni 6 Publiciteti

Të dyja palët synojnë të gjenerojnë vullnet të mirë dhe të ndajnë sukseset dhe mësimet me publikun. Nëse është planifikuar shtyp, të dyja palët do të sigurojnë kopje të njoftimeve për shtyp ose postimeve të blogjeve për palën tjetër për shqyrtim para publikimit. Publikimi duhet të pasqyrojë marrëdhënien pozitive dhe reciprokisht të dobishme, por jo ekskluzive në të cilën është bërë një donacion pa u angazhuar në obligime ose angazhime formale jashtë atyre të përmendura në këtë Memorandum.

Neni 7 Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, AIDSSH dhe WoALUG do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 8 Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshjeje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e AIDSSH dhe WoALUG, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 9 Mirëbesimi

1. AIDSSH dhe WoALUG do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

Neni 10
Afati i marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.


Neni 11
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në depozitohen në **Wikimedians of Albanian Language User Group (WoALUG)**.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi
Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**

Gentiana SULA



KRYETARE E AUTORITETIT

Për

**Wikimedians of Albanian Language
User Group (WoALUG)**

Greta DOÇI



ANËTARE BORDI